

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**"MANAGEMENT HOSPITALITY ALBANIA" SHPK**

Sot më datë 11 Tetor 2022, ne përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme ortakët e nënshkruajnë dhe miratojnë këtë Statut me qellim krijimin e Shoqërisë "MANAGEMENT HOSPITALITY ALBANIA" shpk, me përbajtje si me poshtë.

**TITULLI I**  
**Themelimi, emërtimi, objekti, kohëzgjatja, selia dhe hapësira në internet**

**Neni 1: Data e themelimit, emërtimi dhe ortakët**


Emri i Shoqërise së re të krijuar është "MANAGEMENT HOSPITALITY ALBANIA" Shpk. (këtu e më poshtë Shoqëria). Ortak i Vetëm i Shoqërisë zotëruesh i një kuote qe perben 100% te kapitalit të shoqërisë është :

- **Shoqëria "Concord Investment" SHPK** person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 14.06.2005, me Vendimin Nr. 33729, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën: rruga "Perlat Rexhepi" Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, me NUIS K81602049K, **i përbërë nga ortakët:**
  - **Z.Artan Dulaku**, zotëruesh i një kuote që përfaqëson 34% (Tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
  - **Z.Adrian Dulaku**, zotëruesh i një kuote që përfaqëson 33% (Tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
  - **Z.Genci Dulaku**, zotëruesh i një kuote që përfaqëson 33% (Tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet tregtar sipas objektit të veprimitarisë pëershkuar më poshtë:

"Aktivitet në fushën e turizmit, hapja dhe manaxhimi i hoteleve, e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier. Menaxhim dhe administrim i pasurive të paluajtshme, kryesisht me veprimtari në Hoteleri – Turizëm. Investime në fushën e hotelerisë dhe turizmit, hapjen e bareve dhe restoranteve brenda këtyre strukturave, hapjen, administrimin dhe/ose menaxhimin e lojraleve të fatit dhe kazinove brenda hoteleve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kryerje e shërbimeve të agjensive për veprimtari turistike brenda dhe jashtë vendit. Organizimin e aktiviteteve me natyrë sportive e argëtuese. Import – Eksport të mallrave e artikujve të ndryshëm industrialë dhe ushqimore, produkteve të estetikës dhe dermoestetikës, të pajisjeve dhe mjeteve të kazinove, aksesore hotelerie etj. Shërbim shpërndarje (Delivery) për bar dhe restorant. Hapja dhe manaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, administrimi dhe / ose menaxhimi i funksionimit të qendrave të rekreacionit, me ose pa profil të dermo-estetikës, trajtimi të lëkurës dhe trupit ,



për masazhe, spa, mirëmbajtje trupore, fitness, dhe pishina. Aktivitet në fushën e qiradhënisë së zyrave, ambjenteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që i përkasin hotelit. ”.

#### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve.

#### **Neni 4: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike**

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: **Rruga “Perlat Rexhepi” Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë**. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e R.SH., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **TITULLI II**

#### **Kapitali**

#### **Neni 5: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **100.000 lekë (Njëqind mijë Lekë)**, i përbërë nga 1 (një) kuotë.


(1) Kontributi i ortakëve në kapitalin e Shoqërisë është si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria “Concord Investment” shpk është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë (Njëqind mijë Leke), e cila përbën 100% (Njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë”.

#### **Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe tërheqja e kuotave të papaguara**

(1) Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën katërmëdhjetë ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, siç përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilin i drejtohet thirrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrja për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote mbajnë përgjegjësi bashkarisht dhe veçmas për të shlyer të



gjitha thirrjet për pagesë të kontributit të cilat lidhen me këtë kuotë.

(3) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e pashlyer në fund të afatit të vet, personi të cilit i drejtohet thirrja dhe i cili është përgjegjës për pagesën paguan një interes mbi shumën e papaguar, duke filluar nga dita kur mbaron afati deri në momentin e pagimit me një normë vjetore interes prej 4%.

(4) Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se katërmëdhjetë ditësh të tjera personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumular. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet detyrimi, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, anullohen.

(5) Nëse njoftimi nuk zbatohet, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të bëhet pagesa e kërkuar nga njoftimi, mund të térhiqet me vendim të Administratorit dhe térheqja përfshin edhe të gjithë dividendift ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e térhequra dhe të papaguara deri në momentin e térheqjes.

(6) Në varësi të parashikimeve të Ligjit, një kuotë e térhequr mund të shitet, të rishpérndahet ose të hiqet në bazë të kushteve dhe mënyrës që konsiderohet e arsyeshme nga Asambleja e Ortakëve.


(7) Personi prej të cilit janë térhequr kuotat e kapitalit pushon së qeni ortak në lidhje me kuotat e térhequra por vazhdon të jetë përgjegjës përpara shoqërisë për të gjitha kontributet të cilat janë të pashlyera në datën e térheqjes së kuotave në lidhje me këto kuota së bashku me interesin e llogaritur me normën e interesit të zbatueshëm për këto kontribute përpara térheqjes.

#### **Neni 7: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tillë siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75% (shtatedhjetë e pese përqind) të kapitalit) të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 8: Çertifikatat e kuotave të kapitalit**

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një çertifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e çertifikatës përfaqësuesit të zotëruvesve të përbashkët sipas Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotërues. Emrat e zotëruvesve të përbashkët renditën në çertifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.



### **Neni 9: Kalimi i kuotave me kontratë**


- (1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formalitetave të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet selisë së regjistruar të Shoqërisë.
- (2) Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKB-së nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi, me argumentin se nuk është respektuar e drejta e parablerjes.
- (3) Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, sipas pikës 2, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në Shoqëri, i dërgon marrësit njoftimin për mospranimin.

### **Neni 10: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit**

- (1) Nëse një ortaku vdes bashkëzotëruesh e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruesh i vetëm ose një bashkëzotëruesh i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkarisht.
- (2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesh vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjetër.
- (3) Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gjëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesh i kuotës, me perjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKB-së, ai nuk gjëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

### **Neni 11: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e tij në proporcione pjesët e tyre në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar



kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri. (2) Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë 100% (njëqind përqind) të kapitalit. Në rast zvogelimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

#### **Neni 12: Blerja e kuotave nga ortakët dhe të tjërët**

(1) Ortakët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për blerjen e kuotës/pjesë të kuotës që shitet nga një ortak kundrejt personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkësë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet edhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Ortaku jep ofertën brenda 60 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'u transmetojë ortakëve të tjërë këtë kërkësë dhe ortakët e tjërë duhet të japid një përgjigje brenda 60 ditëve. E drejta e parablerjes duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtar asamblesë.

(2) E drejta e parablerjes është proporcionale në raport me përqindjen e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten.

(3) Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 ditëve, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjërë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet me akte notariale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e ortakëve.

### **TITULLI III**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 13: Mbledhja e Asamblese se Përgjithshme dhe vendim-marrja**

(1) Administratori mund të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme kur ta mendojë të arsyeshme vetë dhe duhet të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë ta kërkojnë ortakët në përputhje me Ligjin.

(2) Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën shtatë ditë të plota kalendarike përpresa mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku



me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

(3) Mosveprimi i paqëllimtë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

(4) Përveç rasteve të përmendura në këtë statut, kërkohet vota pro e ortakëve që zotërojnë jo më pak se 75% të kapitalit për çështjet e mëposhtme:

- a. Ndryshimi i statutit;
- b. Shpërndarjen e fitimit;
- c. Riorganizimin dhe/ose prishjen e shoqërisë

#### **Neni 14: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**


(1) Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në Ligj. Ortakët ose zotërueshit e prokurave të votimit mund të janë të pranishëm përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Ligjit. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

(3) Nëse asnjëri prej Administratorëve nuk ka dëshirë të jetë Kryetari i mbledhjes ose nëse asnjëri prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e vendosur për të mbajtur mbledhjen, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre për të drejtuar mbledhjen si Kryetar i saj.

(4) Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmëbhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e



përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

(6) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se pesë përqind të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak, ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

(7) Nëse nuk kundërshtohet nga një ortak, deklarata nga ana e Kryetarit se një vendim është miratuar në mënyrë unanime ose me një shumicë të caktuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi i këtij fakti në procesverbalin e takimit është informacion i formës së prerë i faktit, pa pasur nevojë për provën e numrit apo përqindjes së votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Nëse ka kundërshtime për këtë deklaratë, atëherë zhvillohet një votim i fshehtë për të përcaktuar numrin e votave të hedhura pro dhe kundër vendimit.

#### **Neni 15: Votat e ortakëve**


(1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi ka të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zotëron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë.

(3) Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit vendimi i të cilit merret bazuar në Statut.

#### **Neni 16: Hetimet e posacme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një audituesi të posacëm sipas Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e Shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë notieriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.



**TITULLI IV**  
**Administratorët**

**Neni 17: Emërimi i administratorëve**

(1) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë për një afat të caktuar. Emërimet i nënshtrohen individualisht një vendimi të zakonshëm i cili, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator, me të drejtë riemërimi. Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në Ligj.

(2) Administrator i shoqërisë emërohet :


**Z. Adrian Dulaku**, atësia Niko, amësia Lirika, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Blv. Bajram Curri; Nd. 142; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, i datëlindjes 05/02/1960, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID nr. 035240347 dhe nr. personal G00205223S, **me një afat 5 vjeçar me të gjitha kompetencat e parashikuara në Statut.**

**Neni 18: Kompetencat e Administratorit**

(1) Veprimtaria tregtare e shoqerise menaxhohet nga Administratori i cili mund t'i ushtroje te gjithe kompetencat e shoqerise qe nuk i rezervuar Asamblese se Pergjithshme nga Neni 81 i Ligjit (6).

Administratori ka keto te drejta dhe detyrime:

- te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise;
- te perfaqesoje shoqerine, ne menyre aktive ose pasive, perpara çdo autoriteti gjyqesor, administrativ, fiskal, ne çdo procedure, ne çdo shkalle te gjykimit, si ne Shqiperi ashtu dhe jashtë saj, me te drejten per te nenshkruar çdo akt ose dokument te nevojshem sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet perkatese, pra, edhe me leshimin e prokurave, mandateve te veçanta per avokate, mbrojtës, te pergjithshme dhe per mosmarreveshje; te leshojne ose te revokojne mandate *ad lites* avokateve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjesve te shoqerise ose te treteve per një ose me shume vepërime, ne kuader te kompetencave perkatese;
- te kryeje çdo operacion financiar dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*; operacione cedimi kredie aktive dhe passive, qe ka lidhje me operacione qe hyjne ne objektin e shoqerise, duke marre persiper angazhime dhe permbushje te formalitetave te nevojshme, duke perfshire dorezanine, gjithnjë ne kufijtë e parashikuar me siper;



- te çelin llogari rrjedhese bankare, te kryeje terheqje parash, te jape dispozita te pageses, te firmose çeqe qe te kene vlore tek keto llogari rrjedhese, edhe te zbuluar, ne kufijte e besueshmerise se atij momenti (overcover), te verifikoje keto llogari rrjedhese dhe te miratoje llogarine;
- te punesoje, te pezulloje, te pushoje nga puna dhe te ndryshoje kushtet qe lidhen me marredhenien e punes se personelit;
- te nderveproje me Entet e Administrates Publike per çdo negocim qe lidhet me oferta, projekte, pjesemarrje, gjithnje brenda kufijve te parashikuar nga objekti i shoqerise;
- te leshoje ekstrakte te borderove dhe vertetime qe lidhen me personelin, si per entet e sigurimeve shoqerore, ashtu dhe per ente te tjera ose private; te kujdeset per respektimin e perm bushjeve, ndaj te cilave shoqeria eshte e detyruar, me te drejten per te nenshkruar deklarata tatimore, qe kane lidhje me mbajtjet nga te ardhurat e punes se varur ose autonome qe jane perdonur;
- te nenshkruaje deklarata fiskale ne lidhje me taksat dhe tatimet ne pergjithesi, si dhe çdo akt ose çertifikate te parashikuar nga legjislacioni fiskal ne fuqi, te kerkonte rimbursime dhe lehtesime nga taksat dhe tatimet, te perfaqesoje shoqerine perpara organeve te administrates fiskale dhe prane komisioneve tatimore te çdo shkalle, me te drejten per te emeruar mbrojtës te posaçem;
- te perfaqesoje shoqerine prane organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qellim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emeruar, nese eshte e nevojshme edhe mbrojtës te posaçem;
- te nenshkruaje komunikimet e bankes mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit ne llogari rrjedhese dhe ekstrakteve periodike te llogarive rrjedhese per vartesit e shoqerise per shumat e depozituara prane saj;
- te nenshkruaje kontrata shitblerje te mallrave dhe sherbimeve, ne kufijte e objektit te shoqerise;
- te marre dhe te jape ne koncession per ekzekutimin e puneve dhe administrimin e çdo lloji, duke firmosur kontratat perkatese, duke marre pjese, nese eshte e nevojshme ne ankande publike dhe private, duke emeruar nese duhet, te mandatuar te posaçem, per te marre pjese ne tenderat perkates pa limit shume;
- te mbaje dhe te nenshkruaje korrespondencen e shoqerise;



- te marre masat per llogari, ne emer dhe ne interes te shoqerise per arketimin dhe terheqjen e e te gjitha shumave dhe te te gjitha vlerave qe i detyrohen per çdo arsyе ose titull, shoqerise nga kushdo qofte, si administratat e Shtetit ose organeve te pushtetit lokal dhe per shlyerjen e mandatave qe jane emetuar ose qe do te emertohen ne te ardhmen, pa kufij kohe, ne favor te shoqerise per çdo shume kapitali ose interes qe shoqerise i detyrohet nga administratat e siperpermendura dhe nga zyrat dhe institutet e sipertreguar, qofte ne likuidimin e depozitave te kryera nga vete shoqeria, qofte per çdo arsyе ose titull, te leshoje ne emer te shoqerise deftesat perkatese apo çdo deklarate tjeter te kryerjes se pageses dhe te shkarkimit nga pergjegjesia dhe ne pergithesi te te gjitha atyre deklaratave qe mund te kerkohen ne kryerjen e praktikave te veçanta perfshire ajo e perjashtimit te zyrave, administratave dhe instituteve te sipertreguar nga çdo pergjegjesi perkatese;
- te emeroje te mandatuar te posaçem per te terhequr vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe te siguruara prane zyrave postale dhe telegrafike;
- te terheqe vlera, letra postale, pako, letra rekomande dhe te siguruara prane zyrave postale dhe telegrafike;
- te perfaqesoje shoqerine ne zhvillimin e te gjitha praktikave qe kane te bejne me veprimtarine e importit dhe eksportit;
- transmetimin e dokumentave, te dhenave dhe njoftimeve;
- te bleje, te shese apo shkembeje makina, mallra, lende te pare dhe sende te luajtshme dhe automjete te regjistruara, te jape dhe te marre komisione, te firmose letra, defteza pagesa, fatura, te xhiroje per arketim çeqe, kambiale dhe tituj te tjere krediti;
- te ndertoje, te perfundoje dhe te administroje marredhenie bankare, duke rene dakord mbi afatet dhe kushtet;
- te kryeje çdo formalitet per firmosjen e nje akti dhe/ose dokumenti me qellim depozitim e akteve dhe dokumenteve te shoqerise prane Gjykates, Dhomes se Tregtise, Zyrave Fiskale dhe Enteve te tjera;
- te perfaqesoje shoqerine ne asamblete e shoqerive te tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe ne marredheniet me keto ente, organet e tyre dhe ortaket ose te asociuarit e tyre, dhe te emeroje perfaquesues, te delegoje me mandat dhe/ose prokure, aq sa i takon kompetencave te tij.

- t'i jape ekzekutim, ne kufijte e kostos se parashikuar nga plan-biznesi dhe nga buxheti i shoqerise, i miratuar paraprakisht nga Asambleja e Ortakeve, investimeve dhe veprimtarive te parashikuara ne to;

(2) Administratori mund t'ia delegoje kompetencat e tij komiteteteve qe perbehen nga nje ose me shume anetare. Nje delegim i tille mund te behet ne varesi te kushteve qe mund te vendose Administratori dhe mund te revokohet ose te ndryshohet.

(3) Asnje ndryshim i Statutit dhe asnje direktive nga ana e Asamblese se Pergjithshme nuk mund t'i beje te pavlefshme veprimet e meparshme te Administratorit te cilat do te kishin qene te vlefshme nese nuk do te ishte bere ndryshimi ape nese nuk do te ishin dhene direktiva.

(4) Administratori nuk mund te delegoje asnjerën prej detyrimeve te cilat ja ngarkon ligji.

#### **Neni 19: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit**

Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë 100% të kuotave.

#### **Neni 20: Kufizimet për votimin**

(1) Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtëpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas Ligjit, nëse me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
2. ta autorizojnë të vendosë për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprosim i përgjithshëm duhet të registrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumi të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote.

#### **Neni 21: Procesverbalet e mbledhjeve të Administratorëve**

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë procesverbalet e të gjithë takimeve/mbledhjeve të bëra nga Administratori.

### **KAPITULLI V**

#### **Dividentët dhe kapitalizimi i fitimeve**

## **Neni 22: Dividentët**

- (1) Pas përbushjes se kërkesave të Ligjit, Shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të shpallë dividente me përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhen në përputhje me përqindjen takuese të secilit ortak. Por, nëse një kuotë emetohen me kushtin se përfiton divident duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividentin sipas këtij kushti.
- (3) Secili ortak mund t'i paraqes kërkesë administartorit qe ne Mbledhjen e Asamblese per miratimin e rezultateve financiare dhe destinimin e te ardhurave vjetore te merret ne shqyrtim pagimi i dividentit qe do t'i përkiste këtij ortaku. Ne rast se pagesa e dividentit eshte e pranueshme ne përputhje me rezultatet e aktivitetit te shoqërisë si dhe ne përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe Ligji per shoqëritë teretare, Adminisratori e përfshinëkerkesen e orakut ne rendin e ditës te Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve. Ortakët nuk mund të pengojnë, qoftë edhe me vendim të veçantë të shumicës, pagimin e dividentit për një apo disa ortakë të cilët kërkojnë shpërndarjen e dividentit.
- (4) Asnjë divident dhe asnje mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës.

## **Neni 23: Kapitalizimi i fitimeve**


Me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Ligji, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të Shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividente preferenciale ose borxhe të tjera të pashtyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

## **TITULLI IV**

### **Prishja dhe Njoftimet**

## **Neni 24: Prishja dhe Likuidimi**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesit me autoritetin që i jep një vendim i kualifikuar i Asamblesë së Përgjithshme që përbën 75% të kapitalit të Shoqërisë, dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i shpërndajnë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojnë pasuritë dhe të përcaktojnë se si do të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.



**Neni 25: Njoftimet**

- (1) Njoftimet që i jepen ortakëve ose që ata bëjnë sipas Statutit duhet të janë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik.
- (2) Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me poste në një zarf për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje Ligjin.

**Neni 26: Dispozita të përgjithshme**

Përsa i përket çëshjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Legjisacionit në fuqi.

Çdo mosmarrëveshje që del nga ky Statut, nëse nuk zgjidhet me marrëveshje mes palëve, do të zgjidhet para gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 27: Dispozita përfundimtare**

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe. Statuti mbylljet me 27 (Njëzet e shtatë) nene. Ky statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

**Emrat dhe Nënshkrimet e Ortakut Themelues të :**

**Shoqërisë Tregtare “MANAGEMENT HOSPITALITY ALBANIA” SH.P.K.**

**Ortaku Themelues**

**“Concord Investment” shpk**

**Përfaqësuar nga :**

**Z.Adrian Dulaku**

**Z.Artan Dulaku**

**Z.Genci Dulaku**

